



Breaking News:

Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar “Last Scheme”, zbardhet vjedhja në një banesë në Sharrë



Lajmet

Operacionet

25/08/2026

Tiranë/Ndërhyrja E Menjëhershme E Policisë Neutralizoi Një Konflikt Ndërmjet 2 Shtetasve, Në Laprakë

Tiranë/Ndërhyrja e menjëhershme e Policisë neutralizoi një konflikt të ndodhur mbrëmë, në Laprakë, ndërmjet 2 shtetasve, njëri prej të cilëve ishte i armatosur.

Goditi me qytën e pistoletës që mbante pa leje, një 47-vjeçar, për motive të dobëta, arrestohet në flagrancë 37-vjeçari.

Vihet në hetim 47-vjeçari, për moskallëzim të këtij krimi.

Sekuestrohet arma e zjarri me krehrin dhe fishekët.

Menjëherë pas njoftimit për një konflikt në rrugën “Eshref Frashëri”, ndërmjet 2 shtetasve, rreth orës 21:45 të datës 24.08.2026, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, organizuan punën dhe shkuan në vendngjarje, për të sqaruar rrethanat dhe përgjegjësitë në lidhje me këtë rast.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe operationale u neutralizua konflikti, si dhe u arrestua në flagrancë shtetasi I. K., 37 vjeç, banues në Krujë, i cili dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me qytën e armës së zjarrit (pistoletë) që mbante pa leje, shtetasin A. M., 47 vjeç, banues në Laprakë.

Në vijim të këtyre veprimeve nisi procedimi në gjendje të lirë për 47-vjeçarin, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.



Tiranë/Ndërhyrja e menjëhershme e Policisë neutralizoi një konflikt
Policia e Shtetit



Watch on

◀ Ksamil/Shkeli perimetrin e sigurisë, me mjet lundrues, ndëshkohet me gjobë dhe i bllokohet mjeti

Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar “Last Scheme”, zbardhet vjedhja në një banesë në Sharrë ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

